



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**MARRËVESHJE**

**“PËR NJË NDRYSHIM NË MARRËVESHJEN PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE  
TË NËNSHKRUAR MES KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT  
DHE BASHKISË TIRANË, NË DATË 10.11.2017”**

Sot, më datë 29.05.2023, Palët e mëposhtme:

**Këshilli Kombëtar i Territorit**, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT  
Z. Edi Rama

dhe

**Bashkia Tiranë**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Erion Veliaj

Në mbështetje të neneve 28, 29 dhe 113, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7 shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të KKT-së Nr.13, datë 29.05.2023, bien dakord si më poshtë:

**NENI 1**

Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Vecantë, të miratuara me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.03, datë 10.11.2017 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë Polifunkionale Europiane Blloku”, Bashkia Tiranë, zëvendësohen me dokumentet bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.13, datë 29.05.2023 “Për një ndryshim në vendimin e KKT-së Nr.03, datë 10.11.2017 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Godinë Polifunkionale Europiane Blloku”, Bashkia Tiranë”

## NENI 2

Të gjitha kushtet e tjera, si dhe të drejtat e detyrimet e palëve që janë përcaktuar në “Marrëveshjen për Delegimin e Kompetencave” të nënshkruar mes Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Bashkisë Tiranë në datë 10.11.2017, mbeten të pandryshuara.

## NENI 3

Palët do t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

## NENI 4

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë.

## NENI 5

Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj.

Kjo Marrëveshje publikohet në Fletoren Zyrtare.

## PALËT

### KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

Përfaqësuar nga,  
**Z. EDI RAMA**



### BASHKIATIRANË

Përfaqësuar nga,  
**Z. ERION VELIAJ**

